

UDHËZIM
Nr. 25, datë 1.8.2022

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË
26.12.2013, “PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
TË BONOVE TË THESARIT NË FORMË REGJISTRIMI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON :

Në udhëzimin nr. 30, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të Bonove të Thesarit në formë regjistrimi”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 11 bëhet një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë:

a) Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Në varësi të nevojave të huamarrjes dhe kostos së saj, Ministria mund të ndryshojë ose të anulojë ofertën e shpallur. Në rastet kur shuma e kërkuar nga tregu është më e madhe ose e barabartë me ofertën e shpallur, Ministria mund të devijojë nga oferta e shpallur me maksimumin +/-15%. Në rastet kur shuma e kërkuar nga tregu është më e vogël se oferta e shpallur, devijimi mund të jetë edhe më i lartë sesa -15% e ofertës së shpallur; në këtë rast MFE-ja ka të drejtën të ulë shumën e pranuar në ankand deri te shuma apo kërkesa ku fillon të zhvillohet “fat tail” (diferenca ndërmjet yield-it cut-off dhe yield-it mesatar të ponderuar).”.

b) Pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Vendimi për devijimin do të mbështetet në cilësinë e kërkesave, jo në nivelin e yield-eve, duke synuar që yield-i maksimal i pranuar të jetë kufiri i fundit në shpërndarjen normale të serisë së yield-eve të kërkuara.”.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj